

Njoftim i përqendrimit me të cilin CP Sprus Holdings, S.C. Sp., Luksemburg, do të fitojë kontrollin mbi Vantiv Helt LLC., SHBA, Vantiv Meksiko LLC, SHBA, Gambro Rinal Produkts, Inc. SHBA, RTS Vorldvajt Holdings Inc., SHBA, Vantiv Holding B.V. Holandë, Vantiv Helt GmbH, Zvicër dhe Vantiv Holding Limited, SHBA

(lënda nr. 08-139/2024)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta zyrtare e RM” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), 208/24 më 15.10.2024, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës i është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin CP Sprus Holdings, S.C.Sp CP (Spruce Holdings, S.C.Sp), me seli në 2 avenia Sharll de Goll, L-1653, Luksemburg, synon të fitojë kontrollin e Vantiv Helt LLC. , me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej Dijrfield, IL, 60015, SHBA, Vantiv Meksiko LLC, me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej Dijrfield, IL, 60015, SHBA, Gambro Rinal Produkts, Inc. me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej Dijrfield, IL, 60015, SHBA, RTS Vorldvajt Holdings Inc., me seli të regjistruar në Uan Bakster Parkvej Dijrfield, IL, 60015, SHBA, Vantiv Holding B.V. me seli të regjistruar në Kobaltveg 49, 3542 CE Utreht, Holandë, Vantiv Helt GmbH, me seli e saj të regjistruar në Thurgauerstrasse 130 Glatpark (Opfikon), Cyrih 8152, Zvicër, dhe Vantiv Holding Limited, me selinë të regjistruar në katin e 4-të në St. Paul's Gejt, 22-24 Nju Strit, St Helier, Xhersi, JE1 4TR, Ishujt Kanal, SHBA.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit:

CP Sprus Holdings, S.C.Sp., është një shoqëri për qëllime të veçanta, e përfaqësuar nga partneri i saj i përgjithshëm CP VIII Paricipations S.a.r.l., një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar në Luksemburg me seli në 2 avenia Sharll de Goll, L-1653, Luksemburg dhe e regjistruar në Regjistrin e Tregtisë dhe Kompanive të Luksemburgut, i cili kontrollohet në mënyrë indirekte nga shoqëritë e varura të Karlajl Group Inc. (Carlisle Group Inc. së bashku me fondet e kontrolluara dhe shoqëritë e varura më poshtë si „Karlajl“).

Karlajl është një menaxher global i mjeteve alternative, duke menaxhuar fondet që investojnë globalisht në tre disiplina investimi:

Kapitali privat global (duke përfshirë kapitalin privat të korporatave, fondet e pasurive të paluajtshme dhe burimeve natyrore);

Kredia globale (përfshirë kreditë likuide, huatë jolikuide dhe huatë e mjeteve reale); dhe

Zgjidhjet e investimeve (programi i fondeve të kapitalit privat, të cilat përfshijnë fondet parësore, aktivitetet dytësore dhe të lidhura me bashkë investimin).

Karlajl ka 3 (tre) shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut:

- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime informatike DEPT TEHNOLOXHI MAQEDONIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në ul. Maxim Gorky nr. 13-kati 3/BC. Nastel, Shkup – Qender, Republika e Maqedonisë së Veriut, EMBS 6594131 dhe aktiviteti prioritar 62.01 – Programimi kompjuterik ("**DEPT TEHNOLOXHI MAQEDONIA SHPKNJP Shkup**").

- Shoqëria për tregti dhe shërbime HSO GLOBAL SERVICES SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Maksim Gorki nr 13-1-4/zgr.1 K.K2, Shkup - Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, NUAS 7311346 dhe aktiviteti prioritar 62.02 - Veprimtari konsulente kompjuterike ("**HSO GLOBAL SERVICES SHPKNJP Shkup**").

- Shoqëria për zhvillim dhe prodhim softuerësh MAK SISTEM SOFTVER SHPKNJP Shkup, me seli në rr. Londonska nr. 1, Shkup - Karposh, Republika e Maqedonisë së Veriut, NUAS 6541003 dhe aktiviteti prioritar 62.09 - Shërbime të tjera në lidhje me teknologjinë informatike dhe kompjuterët ("**MAK SISTEM SOFTVER SHPKNJP Shkup**").

Vantiv është divizioni i kujdesit për veshkat e Bakster International Inc. ("**Bakster**"). Vantiv është kryesisht aktive në furnizimin e produkteve të terapisë zëvendësuese të veshkave ("**RRT**"). Produktet RRT përdoren për të trajtuar pacientët që vuajnë nga sëmundja e veshkave në fazën përfundimtare („ESRD“), e cila është forma më e rëndë e dështimit të veshkave. Dështimi i veshkave ndodh kur veshkat nuk filtojnë gjakun, duke rezultuar në depozitimin e mbetjeve dhe toksinave në qarkullimin e gjakut.

Operacionet e Vantiv kanë dy ndarje kryesore:

Terapitë kronike, të përbërë nga një portofol produktesh për Dializën Peritoneale ("**PD**") dhe Hemodializën ("**HD**") dhe

Terapitë akute ("**AT**") që përbëhen nga terapia e vazhdueshme e zëvendësimit të veshkave ("**CRRT**") dhe terapi të tjera mbështetëse të organeve të përdorura në njësinë e kujdesit intensiv ("**ICU**").

Për plotësinë, "dializa" i referohet trajtimit që synon të zëvendësojë aspektet e funksionit të veshkave tek njerëzit, funksioni i veshkave të cilëve po dështon (HD dhe PD janë dy modalitete të dializës).

Vantiv do të përbëhet nga shoqëritë e mëposhtme:

- **Vantiv Helt LLC**- shoqëri holding me aktivitet të kufizuar operativ.

- **Vantiv Meksiko LLC** - shoqëri holding për subjektet që operojnë në Meksikë.

- **Gambro Rinal Produkts, Inc.** shoqëri Holding për Pronën Intelektuale.

-**RTS Vorldvajd Holdings Inc.** - shoqëri holding për subjektet që operojnë me klinikat e dializës jashtë SHBA-së dhe operacionet teknike në SHBA.

- **Vantiv Holding BV** - shoqëri holding për subjekte operative dhe jo operative jashtë SHBA.

-**Vantiv Helt GmbH** qëllimi i të cilit është prodhimi, zhvillimi, importi, eksporti, blerja, shitja, licencimi, shitja, shpërndarja, sigurimi, riparimi, instalimi, programimi dhe mirëmbajtja në emër të tij dhe në llogari të tij, ose si përfaqësues i shitjeve ose komisioner/tregtar, i produkteve të kujdesit shëndetësor, farmaceutikëve, pajisjeve mjekësore dhe terapive, produkteve dhe shërbimeve përkatëse.

-**Vantiv Holding Limited**, është një kompani holding pa aktivitet operacional.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim te Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

24.10. 2024

Shkup